LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT PËR KULTURAT BUJQËSORE
DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Rrethina, fshati Shtoi i Vjetër

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Kul. bujq. vlera, lekë	Dru frutorë vlera, lekë	Totali, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri							
1	Arta	Haxhija	3429	101/31	70		10000	10000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Fadil	Mehmeti	3429	120/16	70		15000	15000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Luigj	Marinaj	3429	120/15	140		33000	33000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Vitor	Nika	3429	338/25	60		4000	4000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Idriz	Kolaka	3429	100/3	25		27000	27000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Lic	Elezi	3429	100/11	40	500	10500	11000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Hamza	Kodraviq	3429	101/40	45		36000	36000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Shygyri	Kodraviq	3429	101/41	126		42000	42000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						500	177500	178000	



MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT PËR KULTURAT BUJQËSORE
DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Rrethina, fshati Shtoi i Ri

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Dru frutorë vlera, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri					
1	Fabri	Lekaj	3428	51/19	75	42000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Xhemal	Jakupi	3428	124	30	7000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Mustaf	Kurtulaj	3428	51/13	110	17500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Gjergji	Ahi	3428	123/5	320	16500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Tahir	Lisi	3428	161/23	130	36500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Trazhgimtaret	Lulja	3428	110/11	350	56500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Ismet	Zenelaj	3428	107/1	240	28500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Hasije	Piroviç	3428	51/15	80	11000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Pashko	Lakaj	3428	31/10	14	6000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Agustin	Rrushaj	3428	29/5	122	27500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Gezim	Therçaj	3428	31/11	32	11500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Sulejman	Rrukaj	3428	161/29	60	24000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						284500	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT PËR KULTURAT BUJQËSORE
DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Gruemirë, fshati Ktosh

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Dru frutorë vlera, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri					
1	Muhamet	Beqaj	17/66	1063/16	81	68500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Deli	Beqaj	17/66	1063/22	20	22500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						91000	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT PËR KULTURAT BUJQËSORE
DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Rrethina, fshati Golem

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Dru frutorë vlera, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri					
1	Ymer	Lecaj	1790	29/25	90	18000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Ramadan	Lecaj	1790	29/24	15	9000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Hava	Qershija	1790	29/20	67	10000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sami	Çinarja	1790	29/16	100	20000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Gezim	Hysja	1790	29/23	50	5500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						62500	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT
PËR KULTURAT BUJQËSORE DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Gruemirë, fshati G. Çesme

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Dru frutorë Vlera, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri					
1	Hajdar	Gjetaj	1465	553/4	148	15000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Fadil	Pavacaj	1465	319/3	117	12000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Ramadan	Hasumja	1465	555/1	140	111200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						138200	

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-HANI I HOTIT PËR KULTURAT BUJQËSORE
DHE DRUFRUTORE

Qarku: Shkodër, komuna Rrethina, fshati Dobraq (qytet)

Nr.	Pronari		Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. shpr. m ²	Sip. vlera, lekë	Kul. bujq. vlera, lekë	Dru frutorë totali, lekë	Shënime
	Emri	Mbiemri							
1	Bedrije	Haxhja	8592	6/204	40		23000	23000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Vidan	Broja	1495	14/17	15		6000	6000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Lulash	Arinaj	1495	193/50	20		33500	33500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Aleksander	Malocaj	1495	193/28	122		23800	23800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Precç	Gurra	1495	193/27	30	450	4500	4950	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Dode	Poroshaj	1495	153/47	14		19000	19000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Niko	Nika	1495	28/30	110	6150	7000	13150	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Hysen	Zmijani	1495	28/43	350		47000	47000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Trashgimtarët	Haxhja	1495	2812	84		19500	19500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI							6600	183300	189900

VENDIM

Nr. 703, datë 10.10.2012

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE, SHKODËR (OBJEKTET)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Unaza Lindore, Shkodër.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë objekte, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 29 831 936 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 29 831 936 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë nga data 15 tetor 2012.
7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, në përputhje me vendimin nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, në bazë të vendimit nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.



9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Shkodër dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**OBJEKTET SHITESË TË NDËRTIMIT QË SHPRONËSOHEN PAS NDRYSHIMIT TË
PROJEKTIT TË SEGMENTIT RRUGOR UNAZA LINDORE SHKODËR**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Objekte ndërtimi

Përmbledhëse totale

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pas.	Vlera në lekë sipas preventivit	Lloji i objektit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Nikoll	Zef	Dushaj	8593	12/92	1,638,315	Dyqan	Proces legalizimi
2	Tonin	Martin	Shqau	8594	10/191	2,307,450	Dyqan	Proces legalizimi
3	Tonin	Martin	Shqau	8593	10/191	3,087,029	Banesë	Proces legalizimi
4	Nike	Vuksan	Marashi	8593	11/363	1,062,717	Dyqan	Proces legalizimi
5	Lulzim	Çun	Deda	8592	8/640	2,586,037	Banesë	Proces legalizimi
6	Zef	Ndrekë	Boka	8592	8/635	6,156,459	Shtëpi	Proces legalizimi
7	Lin	Martin	Preka	8593	11/366	2,172,683	Objekt ndërtimi	Proces legalizimi
8	Tom	Lulash	Ndershtiqaj	8593	11/101	1,403,165	Banesë	Proces legalizimi
9	Tonin	Mhill	Buxhaj	8592	8/639	4,830,592	Dyqan	Proces legalizimi
10	Zoja	Deli	Zorgji	8593	12/88	784,552	Banesë	Proces legalizimi
11	Frano	Dede	Shqau	8594	9/116	1,660,174	Magazinë	Proces legalizimi
12	Shtjefën	Kole	Ziçi	8594	10/527	864,917	Dyqan	Proces legalizimi
13	Ndoc	Kol	Marku	8594	12/599	1,277,846	Dyqan	Proces legalizimi
						29,831,936		

VENDIM
Nr. 704, datë 10.10.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 602, DATË 24.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE
KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANDET JAPONEZE PËR SEKTORIN E
BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 602, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “... të derdhen në buxhetin e shtetit...”, zëvendësohen me fjalët “... të derdhen pjesë-pjesë në buxhetin e shtetit, në përputhje dhe në varësi të fondit të kontraktuar...”.
2. Në pikën 1.1, fjalët “... shuma prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh ...” zëvendësohen me fjalët “... shuma e kontraktuar ...”.
3. Në pikën 2, fjalët “... këto fonde ...” zëvendësohen me fjalët “... fondet e kontraktuara ...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 705, datë 10.10.2012

PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË AUTOMJETEVE NË FUND TË JETËS*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI

Ky vendim ka për qëllim:

1. Miratimin e kërkesave për parandalimin, minimizimin dhe ripërdorimin e mbetjeve që dalin nga automjetet në fund të jetës, si dhe komponentëve të tyre, duke kontribuar në këtë mënyrë në mbrotjtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.
2. Nxitjen e operatorëve ekonomikë të përfshirë në ciklin e jetës së automjetit për ngritjen e sistemeve për grumbullim, trajtim, ripërdorim dhe riciklim të automjeteve në fund të jetës.

II. OBJEKTI

CELEX Reference: 32000L0053

* Ky vendim transponon plotësisht direktivën 2000/53/KE e Parlamentit dhe të Këshillit Europian të datës 18 shtator 2000 “Për automjetet në fund të jetës”; Gazeta Zyrtare L 269, 21/10/2000 P. 0034-0043.



1. Objekt i këtij vendimi janë të gjitha automjetet e përcaktuara si kategoria M1 dhe N1, automjetet me tri rrota, por duke përfshirë triciklat më motorë.

2. Objekti i vendimit janë edhe pjesët e këmbimit të automjeteve dhe ato të zëvendësuara, pa u përqendruar në vlerën e tregut.

3. Ky vendim nuk zbatohet për automjetet historike ose automjetet me vlerë për koleksionuesit ose që destinohen për muzeumet, të ruajtura në mënyrën e duhur.

4. Për automjetet motorike me tri rrota do të zbatohen kërkesat e ndarjeve VII/1 dhe IX, të këtij vendimi.

III. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e përdorur kanë këto kuptime:

1. “Automjet” ka kuptimin që jepet në pikën 2 të nenit 47 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

2. “Automjet në fund të jetës”, që më poshtë do të përdoret “automjeti i dalë jashtë përdorimit”, nënkupton automjetin i cili është mbetje, në kuptim të pikës 31 të nenit 3 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Automjeti konsiderohet në fund të jetës i dalë jashtë përdorimit, kur ka përfunduar procesi i lëshimit të certifikatës së shkatërrimit dhe është bërë çregjistrimi i tij nga regjistri i autoriteteve të qarkullimit rrugor.

3. “Kategoria M1” përfshin automjetet që përdoren për transportin e udhëtarëve dhe të përbëra nga jo më shumë se tetë vende, përveç vendit të shoferit (neni 47 i Kodit Rrugor).

4. “Kategoria N1” përfshin automjetet që përdoren për transportin e mallrave dhe të ketë një maksimum ngarkese jo më shumë se 3.5 tonë (neni 47 i Kodit Rrugor).

5. “Prodhues”, prodhuesi i automjetit ose importuesi profesionist i automjetit.

6. “Menaxhim i automjeteve të dala jashtë përdorimit”, parandalimi, grumbullimi, trajtimi, ripërdorimi, riciklimi dhe rikuperimi i automjetit në fund të jetës apo komponentëve të tij.

7. “Parandalim”, masat që synojnë reduktimin e sasisë së dëmit në mjedis të shkaktuar nga automjetet e dala jashtë përdorimit, materialet dhe substancat e tyre.

8. “Trajtim”, çdo aktivitet i kryer pasi automjeti në fund të jetës të jetë dorëzuar tek një operator për dekontaminimin, çmontimin, shkatërrimin, copëtimin dhe riciklimin.

9. “Ripërdorim”, çdo operacion me anë të të cilit komponentët e automjeteve të dala jashtë përdorimit përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin ato janë konceptuar në një automjet tjetër.

10. “Riciklim” ka kuptimin që jepet në pikën 40 të nenit 3 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

11. “Rikuperim i energjisë”, përdorimi i mbetjeve të djegshme si një mjet për të gjeneruar energji nëpërmjet djegies së drejtpërdrejtë me ose pa mbetje të tjera, por me rikuperimin e nxehtësisë.

12. “Rikuperim” ka kuptimin që jepet në pikën 39 të nenit 3 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

13. “Operatorë ekonomikë”, një prodhues, shpërndarës, mbledhës, kompani për sigurimin e automjeteve motorike, çmontues, riparues, riciklues ose çdo operator tjetër trajtimi për automjetet e dala jashtë përdorimit.

14. “Substancë e rrezikshme” ka kuptimin që jepet në pikën 17 të nenit 5 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

15. “Copëtues”, një pajisje që përdoret për ta copëtuar apo fragmentarizuar automjetin e dalë jashtë përdorimit dhe pjesët përbërëse të tij.

16. “Informacion për çmontimin”, çdo informacion që nevojitet për trajtimin korrekt dhe të duhur mjedisor të automjeteve të dala jashtë përdorimit. Ky informacion do t’u jepet njësisë të autorizuar për trajtim nga prodhuesit e automjeteve dhe prodhuesve të pjesëve përbërëse në formën e manualeve ose nëpërmjet pajisjeve elektronike (p.sh. CD-ROM, internet etj.).

17. “Certifikatë çregjistrimi”, dokumenti zyrtar që lëshohet nga autoriteti përgjegjës për transportin për të treguar që një mjet është hequr nga qarkullimi dhe është çregjistruar nga regjistri përkatës.

18. “Certifikatë shkatërrimi”, një dokument që lëshohet nga operatori që kryen grumbullimin, çmontimin dhe riciklimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit.

19. “Kodifikim i pjesëve të këmbimit”, një proces i pajisjes me një kod specifik i atyre pjesëve dhe materialeve të automjetit të dala jashtë përdorimit, të cilat mund të ripërdoren.

20. “Udhëzues çmontimi”, dokumenti që duhet të shoqërojë mjetet motorike që tregtohen nga operatorët përkatës dhe që shërben si udhëzues për të bërë çmontimin e tyre.

21. “Leje mjedisi” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

22. “Ministria”, ministria përgjegjëse për mjedisin.

23. “Rajon” ka kuptimin e një rajoni të administrimit të mbetjeve, që është përcaktuar në përputhje me planin kombëtar dhe planet rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

IV. ROLI I AUTORITETEVE PUBLIKE

1. Autoritetet publike, qendrore dhe vendore, njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku, në bazë të përgjegjësisve të tyre, miratojnë hapësira të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së trajtimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit, me kërkesë të operatorëve ekonomikë.

2. Autoritetet publike, qendrore dhe vendore, si administruese të mjedisit apo pjesëve të tij, brenda kompetencave të tyre, realizojnë miratimin e vendgrumbullimeve apo vendeve të posaçme ku do të ushtrohen veprimtaritë e përcaktuara në këtë vendim, si dhe monitorimin e zbatimin e këtij vendimi nga strukturat përkatëse.

3. Ministria, në bashkëpunim me autoritetet e tjera publike, qendrore dhe vendore:

3.1 Përkrah dhe nxit nisma private për krijimin e skemave rajonale apo kombëtare të grumbullimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve nga automjetet e dala jashtë përdorimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me planet rajonale apo planin kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

3.2 Këto nisma private nuk prekin të drejtat e prodhuesve dhe të tregtuesve të automjeteve për të krijuar skema individuale apo kolektive të grumbullimit, rikuperimit dhe riciklimit të mbetjeve nga automjetet e dala jashtë përdorimit.

V. ÇREGJISTRIMI I AUTOMJETIT TË DALË JASHTË PËRDORIMIT

1. Përdoruesi ose pronari i fundit i automjetit të dalë jashtë përdorimit është përgjegjës për çregjistrimin e automjetit.

2. Çregjistrimi kryhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2012 të ministrit përgjegjës për transportin.

VI. PARANDALIMI

Për të parandaluar prodhimin e mbetjeve nga automjetet e dala jashtë përdorimit, ndotjen e mjedisit, si dhe rrezikimin e shëndetit të njerëzve, kërkohet:

1. Kufizimi në përdorimin e substancave të rrezikshme, duke vepruar, si më poshtë vijon:

1.1 Që prej datës 1 janar 2015, çdo prodhues i automjeteve, në bashkëpunim me prodhuesit e pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve, nxit parandalimin e mbetjeve duke:

i) kufizuar dhe ulur përdorimin e substancave të rrezikshme në automjete;

ii) projektuar e prodhuar automjete dhe duke marrë parasysh e lehtësuar proceset e çmontimit, ripërdorimit, rikuperimit e në veçanti, riciklimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, pjesëve përbërëse dhe materialeve të tyre.

2. Ndalimi i përdorimit të metaleve të rënda.

3. Që prej datës 1 janar 2015, çdo prodhues do të sigurohet se materialet dhe pjesët përbërëse të automjeteve të mos përmbajnë plumb, merkur, kadmium ose krom gjashtëvalent.



4. Prodhuesit e automjeteve, të materialeve dhe pjesëve të këmbimit të tyre, duhet t'i emërtojnë dhe t'i etiketojnë këto materiale dhe komponentë të automjeteve, përpara trajtimit të mëtejshëm të tyre.

5. Ministri dhe ministri përgjegjës për transportin përcaktojnë me udhëzim të përbashkët masat dhe programet për parandalimin e mbetjeve që prodhohen nga automjetet e dala jashtë përdorimit ose të komponentëve të tyre.

VII. GRUMBULLIMI

1. Operatorët ekonomikë të grumbullimit dhe trajtimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit ngrenë sisteme për grumbullimin dhe trajtimin e të gjitha automjeteve të dala jashtë përdorimit dhe, kur është e realizueshme teknikisht, edhe të pjesëve të ripërdorshme, në përputhje me planin kombëtar dhe planet rajonale të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2. Operatorët ekonomikë duhet të shmangin dëmtimin e pjesëve që përmbajnë lëngje ose të pjesëve të këmbimit të ripërdorshme, konkretisht duke vepruar, si më poshtë vijon:

a) materialet dhe komponentët e rrezikshëm hiqen dhe ndahen në mënyrë të tillë që të mos ndotin mbetjet e tjera të çmontuara të automjeteve të dala jashtë përdorimit;

b) automjetet e dala jashtë përdorimit kalojnë së pari procesin e dekontaminimit, i cili nënkupton ndarjen e tyre në mënyrë të kontrolluar dhe grumbullimin në enë të posaçme;

c) operacionet e çmontimit dhe magazinimit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë përshtatshmërinë e komponentëve të automjetit për ripërdorim dhe rikuperim dhe në veçanti për riciklim.

VIII. CERTIFIKATAT

1. Operatorët ekonomikë për trajtimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit regjistrojnë në regjistrin e hyrje-daljeve, përveç përcaktimeve të kërkuara nga neni 17 i ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 edhe përcaktimet e mbetjeve të këtyre automjeteve.

2. Trajtimi i automjeteve të dala jashtë përdorimit nga operatorët ekonomikë, përfshirë dhe procesin e shkatërrimit të tyre, të kryhet pasi të plotësohen kërkesat e nenit 102 të Kodit Rrugor.

3. Certifikata e shkatërrimit lëshohet përpara se automjeti të shkatërrohet nga operatori i trajtimit dhe shërben si kusht thelbësor për çregjistrimin e automjetit.

4. Format i certifikatës së shkatërrimit miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

IX. TRAJTIMI

1. Përgjegjësitë për operatorët

1.1 Çdo operator ekonomik i trajtimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit, që është ose nuk është pjesë e sistemit kombëtar të prodhuesit, do të respektojë rregullat kombëtare për mbrojtjen e shëndetit të njeriut e të mjedisit, si dhe duhet:

i) të ushtrojë aktivitetin e pajisur me lejet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ii) të plotësojë kërkesat minimale teknike për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit, si dhe kërkesat sipas shtojcës bashkëlidhur këtij ligji, të cilat duhet të plotësohen minimalisht nga operatori;

iii) të sigurojë kushtet për ruajtjen (duke përfshirë ruajtje të përkohshme) të automjeteve të dala jashtë përdorimit përpara se ato të bëhen subjekt i trajtimit dhe i riciklimit të duhur;

iv) të ketë kapacitetet e duhura për riciklimin e përbërësve kryesorë të automjeteve në fund të jetës në jo më pak se 75% të tyre;

v) të përmbushë kushtet për ruajtjen e pjesëve që përmbajnë lëngje, përbërës të rrezikshëm dhe pjesë të këmbimit në kushte të përshtatshme dhe të veçanta.

1.2 Kur një automjet i dalë jashtë përdorimit pranohet për trajtim, rikuperim dhe riciklim nga një operator, ndaj pronarit të fundit të mjetit, nuk do të vendoset asnjë tarifë për mjetin që ai dorëzon:

i) që nga data 1 janar 2015, në lidhje me një automjet të regjistruar për herë të parë në autoritetet shtetërore në ose pas datës 1 qershor 2011, ose sipas rastit;

ii) që nga data 1 janar 2013, në lidhje me automjete të tjera.

1.3 Operatori për trajtimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, nuk duhet të pranojë që automjeti të nxirret jashtë përdorimit, kur përbërësit kryesorë të atij automjeti mungojnë apo kur në të janë shtuar mbetje të tjera, që nuk i përkasin atij automjeti. Përbërësit kryesorë të një mjeti janë motori, shasia dhe kabina e tij.

2. Trajtimi dhe riciklimi i automjeteve të dala jashtë përdorimit

2.1 Që nga data 1 janar 2015, kur një automjet i dalë jashtë përdorimit është depozituar për trajtim dhe rikuperim tek operatorët që janë pjesë e sistemit kombëtar të prodhuesit, ai prodhues do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për t'u siguruar se:

i) automjeti i dalë jashtë përdorimit, përfshirë pjesët e këmbimit të identifikueshme në përputhje me këtë vendim, do të trajtohen në përputhje me kërkesat minimale teknike të parashikuara në këtë vendim dhe, në veçanti, me kërkesat minimale teknike për dekontaminimin. Dekontaminimi duhet të kryhet në çdo rast, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas datës së dorëzimit të automjetit të dalë jashtë përdorimit tek operatorët;

ii) dokumentimi konsiston në heqjen e substancave dhe të përbërësve të rrezikshëm. Përbërësit hiqen në mënyrë selektive, duke shmangur ndotjen e përbërësve të tjerë të automjetit të dalë jashtë përdorimit;

iii) proceset për trajtimin dhe ruajtjen e tyre do të kryhen në përputhje me kërkesat minimale teknike, të parashtruara në këtë vendim, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e komponentëve të automjetit për ripërdorim dhe rikuperim dhe, në veçanti, për riciklim.

2.2 Që prej datës 1 janar 2015, kur një automjet i dalë jashtë përdorimit depozitohet për trajtim dhe rikuperim të duhur tek operatorët, pronari ose operatori i trajtimit do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për t'u siguruar se automjeti i dalë jashtë përdorimit, përfshirë edhe pjesët përbërëse dhe materialet e identifikuar, do të trajtohen në përputhje me kërkesat minimale teknike të parashtruara në këtë vendim, e, në veçanti, lidhur me kërkesat teknike minimale për dekontaminim. Dekontaminimi duhet të kryhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas datës së depozitimit të automjetit të dalë jashtë përdorimit nga pronari i tij i fundit tek operatorët e trajtimit, duke vepruar, si më poshtë vijon:

i) substancat dhe komponentët e rrezikshëm duhet të hiqen dhe të ndahen në mënyrë selektive për të mosndotur përbërësit e tjerë të automjetit të dalë jashtë përdorimit;

ii) proceset e trajtimit dhe ruajtja do të kryhen në përputhje me kërkesat minimale teknike, të parashtruara në këtë vendim dhe në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e komponentëve të automjetit për ripërdorim dhe rikuperim dhe, në veçanti, për riciklim.

X. RIPËRDORIMI DHE RIKUPERIMI

1. Duke filluar nga 1 janari i vitit 2015 dhe për secilin vit pasues deri më 31 dhjetor 2019, çdo prodhues do të jetë përgjegjës për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në lidhje me automjetet e dala jashtë përdorimit, të markave të makinave që prodhon apo për të cilat prodhuesi është përgjegjës, ose të makinave të depozituara për trajtim dhe rikuperim tek operatorët e autorizuar për trajtimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit, të përfshira në skemën kombëtare, dhe duhet të përmbushë kushtin e:

i) ripërdorimit apo rikuperimit, në të paktën 85% të këtyre automjeteve sipas peshës mesatare për një automjet për një vit kalendarik;

ii) ripërdorimit dhe riciklimit, në të paktën 80% të këtyre automjeteve sipas peshës mesatare për një automjet për një vit kalendarik.

2. Duke filluar nga 1 janari i vitit 2020 dhe për secilin vit më pas, të gjithë prodhuesit do të jenë përgjegjës për të arritur objektivat e përcaktuar në lidhje me automjetet në fund të jetës, të markës së atij prodhuesi ose për të cilat ka përgjegjësi prodhuesi, të depozituara për trajtim dhe rikuperim tek operatorët, që janë pjesë e sistemit kombëtar të grumbullimit të prodhuesit dhe duhet të përmbushë kushtin e:



i) ripërdorimit dhe rikuperimit në të paktën 95% të këtyre automjeteve sipas peshës mesatare për një automjet në një vit kalendarik;

ii) ripërdorimit dhe riciklimit në të paktën 85% të këtyre automjeteve sipas peshës mesatare për një automjet në një vit kalendarik.

3. Për automjetet e hedhura në tregun shqiptar përpara 1 janarit të vitit 2000, të gjithë prodhuesit do të jenë përgjegjës për arritjen e objektivave të përcaktuar në këtë vendim, në lidhje me automjetet e dala jashtë përdorimit të markave të tyre ose për të cilat është përgjegjës prodhuesi, të depozituara për trajtim dhe rikuperim të përshtatshëm tek operatorët, që përfshin të gjithë sistemin kombëtar të grumbullimit dhe duhet të përmbushë kushtin e:

i) ripërdorimit dhe rikuperimit në të paktën 70% të automjeteve të dala jashtë përdorimit, sipas peshës mesatare për një automjet në një vit kalendarik;

ii) ripërdorimit dhe riciklimit në të paktën 75% të automjeteve të dala jashtë përdorimit.

4. Kur një operator nuk është pjesë e një sistemi kombëtar grumbullimi të një prodhuesi, atëherë pronari ose operatori i asaj njësie të autorizuar trajtimi është përgjegjës për arritjen e objektivave të duhur për ripërdorim, rikuperim dhe riciklim të automjeteve të dala jashtë përdorimit, siç parashtrohet në këtë vendim.

5. Operatorët ekonomikë, që ushtrojnë këtë veprimtari, raportojnë çdo vit pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrisë përgjegjëse për transportin për masën e realizimit të objektivave të vendosur në pikën 2 të kësaj ndarjeje.

6. Format i raportimit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës të transportit dhe punëve publike.

XI. KODIFIKIMI DHE INFORMACIONI PËR ÇMONTIM

1. Standardet e kodimit

a) Duke filluar nga data 1 janar 2015, çdo prodhues i automjeteve në bashkëpunim me prodhuesit e materialeve dhe të pajisjeve, duhet të përdorin të njëjtin standard kodimi për pjesët dhe materialet e përdorura në një automjet, për të lehtësuar identifikimin e atyre përbërësve, që janë të përshtatshëm për ripërdorim.

b) Me marrjen e një kërkesë me shkrim nga organi i caktuar nga ministri, prodhuesi jep dokumentacion teknik dhe informacionin përkatës të përshtatshëm, brenda një periudhe të specifikuar në kërkesën e bërë, për të verifikuar se standardet e kodimit të komponentit dhe të materialit përdoren në përputhje me këtë vendim.

2. Informacioni i çmontimit

a) Që prej datës 1 janar 2015, çdo prodhues i automjeteve ofron informacion çmontimi për çdo lloj automjeti që prodhon dhe ka hedhur në treg brenda gjashtë muajve nga data e hedhjes së parë në treg të atij automjeti.

b) Çdo prodhues i automjeteve, brenda një periudhe të përcaktuar në kërkesën e bërë me shkrim nga organi kompetent, i caktuar nga ministri, jep me shkrim informacionin e çmontimit.

c) Informacioni për çmontimin jepet sipas kërkesave të operatorëve të autorizuar të trajtimit, lidhur me komponentët dhe materialet e ndryshme të automjetit, si dhe vendndodhjen e të gjitha substancave të rrezikshme në automjet.

ç) Çdo prodhues automjetesh pas kërkesës me shkrim u ofron operatorëve të autorizuar të trajtimit të gjithë informacionin e duhur në lidhje me çmontimin, ruajtjen dhe testimin e pjesëve të këmbimit të automjeteve, të cilat mund të ripërdoren, në përjashtim të rasteve të sekretit tregtar dhe industrial.

d) Nga data 1 janar 2015, çdo prodhues i automjeteve boton informacionin, i cili duhet të përmbajë:

i) mënyrën e trajtimit dhe rikuperimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit, si dhe mënyrën e dekontaminimit nga përbërësit e rrezikshëm për markën e automjeteve që ai prodhon;

ii) mënyrat për rikuperim dhe riciklim të mbetjeve të automjeteve të dala jashtë përdorimit për markat që ai prodhon;

iii) informacion për kërkimin dhe projektimin e automjeteve dhe pjesëve të tyre përbërëse që janë lehtësisht të ripërdorshme dhe të riciklueshme;

iv) informacion për përbushjen e objektivave për të reduktuar sasinë e mbetjeve nga automjetet e dala jashtë përdorimit, me qëllim rritjen e shkallës së rikuperimit dhe riciklimit për automjetet që ata prodhojnë.

dh) Çdo prodhues i automjeteve përgatit informacionin e çmontimit, i cili u vihet në dispozicion blerësve të mundshëm të automjeteve. Informacioni i çmontimit duhet të jetë pjesë e informacionit të përdorur në marketimin e automjeteve të reja.

XII. RAPORTIMI DHE INFORMIMI

1. Ministria përgjegjëse për transportin dhe mjedisin raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave për sasinë e automjeteve të çregjistruara, si dhe informon lidhur me arritjen e objektivave të vendosur në ndarjen X të këtij vendimi.

2. Operatorët ekonomikë raportojnë në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe transportin:

a) të dhënat për automjetet që ata tregtojnë dhe nëse pjesët përbërëse të tyre janë të ripërdorueshme dhe të riciklueshme;

b) trajtimin mjedisor të automjeteve të dala jashtë përdorimit, veçanërisht përbërësit e rrezikshëm të tyre;

c) zhvillimin dhe optimizmin e mënyrave dhe teknologjive të ripërdorimit, riciklimit dhe të rikuperimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit dhe të përbërësve të tyre.

XIII. LICENCA E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË DHE LEJA MJEDISORE

1. Operatorët ekonomikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e grumbullimit, trajtimit, ripërdorimit, riciklimit dhe çmontimit të automjeteve motorike në fund të jetës, duhet të pajisen me licencë të nënkategorisë III.2.B dhe leje mjedisore të kategorisë III.1.A, të parashikuara në ndarjen III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullimeve të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin përcakton me udhëzim të veçantë kërkesat specifike mjedisore që duhet të përbushë operatori ekonomik, i cili ushtron veprimtarinë në fushën e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe çmontimit të automjeteve në fund të jetës.

3. Procedura e licencimit dhe pajisjes me leje mjedisore të operatorëve ekonomikë, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë me automjetet e dala jashtë përdorimit, kryhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për lejet e mjedisit”.

XIV. INSPEKTIMI

1. Inspektorati shtetëror kompetent inspekton të gjithë operatorët ekonomikë, që ushtrojnë veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit, ripërdorimit dhe rikuperimit të automjeteve të dala jashtë përdorimit dhe komponentëve të tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” dhe të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Operatorët ekonomikë, mbi të cilët zbatohet ky vendim, i japin inspektoratit shtetëror kompetent të gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve të nevojshme të veprimtarisë që ushtrojnë.

XV. ANKIMET

Ankimi ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve lidhur me licencën me kodin III.2.B dhe lejen mjedisore me kodin III.1, bëhet me kërkesë në QKL në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 10081/2009.



XVI. DETYRIMI PËR ZBATIM

1. Për zbatimin e këtij vendimi brenda funksioneve dhe kompetencave të tyre, ngarkohen organet shtetërore, si më poshtë vijon:

- a) Ministria përgjegjëse për mjedisin;
- b) Ministria përgjegjëse për transportin;
- c) Njësitë e qeverisjes vendore;
- ç) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, miraton udhëzimin për kërkesat specifike mjedisore që duhet të përmbushin operatorët për trajtimin e automjeteve të dala jashtë përdorimit.

3. Ministria përgjegjëse për licencimin e operatorëve ekonomikë, që tregtojnë automjete, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, miraton udhëzimin për kërkesat specifike, që duhet të plotësojë certifikata përkatëse e këtyre operatorëve. Certifikata do të përmbajë informacionin e nevojshëm që automjetet janë projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë, që pjesët përbërëse të tyre të jenë të ripërdorshme dhe të riciklueshme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM

Nr. 16, datë 12.10.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 18.1.2012 “PËR DOKUMENTET E QARKULLIMIT DHE REGJISTRIMIT TË MJETEVE RRUGORE ME MOTOR DHE RIMORKIOVE TË TYRE”

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 92-102 dhe 220-224 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 237-252, 368 dhe 370 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Neni 1

1. Në nenin 3 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje: “d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”
2. Në nenin 3 pika 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje: “d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”
3. Në nenin 3, pas pikës 4 shtohet një pikë 4.1 me këtë përmbajtje: “4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të paregjistruara në Shqipëri.
 - a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njësuar me origjinalin).

c) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.

d) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni.”.

Neni 2

1. Në nenin 7 pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS), sipas rasteve të përcaktuara në nenin 3 të këtij udhëzimi.”.

2. Në nenin 7, pas pikës 1 shtohet një pikë tjetër 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, është i njëjtë me atë të përcaktuar në nenin 3 pika 4.1 të këtij udhëzimi.”.

Neni 3

1. Në nenin 13, pas pikës 1 shtohet një pikë 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, personi i interesuar dorëzon edhe këto dokumente:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njësuar me origjinalin).

c) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit, mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.”.

Neni 4

1. Në nenin 21 pika 2, shkronja “f” ndryshon me këtë përmbajtje:

“f) Dokumenti i fitimit të pronësisë, kur ka ndryshim pronësie.”.

2. Në nenin 21 pika 2, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

3. Në nenin 21 pika 4, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

Neni 5

1. Në nenin 23 pika 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

2. Në nenin 23 pika 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:



“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS)”.

3. Në nenin 23, pas pikës 4 shtohet një pikë 4.1 me këtë përmbajtje:

“4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të paregjistruara në Shqipëri.

d) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

e) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njësuar me origjinalin).

f) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit, mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave”.

g) Dokumenti i zhdoganimit nga autoriteti shqiptar, si në pikën 1 shkronja “c” të këtij neni”.

Neni 6

1. Në nenin 26 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”

2. Në nenin 26, pas pikës 1 shtohet një pikë 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1 Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, personi i interesuar dorëzon edhe këto dokumente:

a) Dokumenti i fitimit të pronësisë, që në këtë rast nënkupton vendimin e gjykatës ose të organit të ngarkuar me ligj, me anë të të cilit mjeti kalon në pronësi të institucioneve të lartpërmendura.

b) Faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal) ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njësuar me origjinalin).

c) Fotokopjen e njësuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin, përveç të tjerave, të evidentohet numri i identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.”.

Neni 7

1. Në nenin 29 pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”

Neni 8

1. Në nenin 36 pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) Dokumenti nga Regjistri i Barrëve Siguruese (RBS).”

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Oildashi

VENDIM
Nr. 136, datë 8.10.2012

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC OSTREN I VOGËL” TË
SHOQËRISË “LU & CO ECO ENERGY 2011”, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “l”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 7 pikat 1 dhe 2 dhe nenit 9 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LU & CO ECO Energy 2011” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues Hec “Ostren i Vogël”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “LU & CO ECO Energy 2011” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues “Hec Ostren i Vogël” të shoqërisë “LU & CO ECO Energy 2011” sh.p.k., si burim të rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM

Nr. 137, datë 8.10.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WENERG” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2, nenet 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Wenerg” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wenerg” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “WENERG” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 138, datë 8.10.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TUCEP” SHPK
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC “TUCEP”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a”, nenit 19 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, neneve 8, 9 dhe 10 pika 3, nenit 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “TUCEP” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Tucep” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Tucep” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Tucep”.
2. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k. të licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Sokol Ramadani**



VENDIM
Nr. 139, datë 8.10.2012

**PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË
SHOQËRISË “HEC-I DRAGOSTUNJE” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike” dhe pikës 5.2 të licencës “Për tregtimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k. është licencuar nga ERE përkatësisht:
 - në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet: “Zanore”, “Dragostunje”; “Hotolisht” dhe “Ura” me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 25, datë 10.3.2011; dhe
 - në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 10.3.2011.
 2. Ristrukturimi i pjesëmarrjes së kapitalit që ka ndërmarrë shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k. shkakton ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat.
 3. Ndryshimi i aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë i shërben zhvillimit të projekteve koncesionare për fazat në vazhdim.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të autorizojë shoqërinë “Hec-i Dragostunje” sh.p.k., për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 140, datë 8.10.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR PERIUdhËN E TRETË
RREGULLATORE 2012–2014 NË ZBATIM TË “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË
TARIFAVE PËR KOMPANINË PUBLIKE TË PRODHIMIT”**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009,

8000

vendimit nr. 77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për gjenerimin publik”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të prodhimit”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014, në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të prodhimit”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 141, datë 8.10.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR PERIU DHËNË E TRETË RREGULLATORE 2012-2014, NË ZBATIM TË “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË”

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për rishikimin e tarifës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. në zbatim të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 142, datë 10.10.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI XHACI” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MOLLAJ”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 5 pika 1 germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Xhaci” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energji Xhaci” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me marrjen e lejes mjedisore është në proces miratimi (neni 9 pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energji Xhaci” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Mollaj” me fuqi të instaluar 0,6 MW.
2. Shoqëria “Energji Xhaci” të paraqesë në ERE lejen mjedisore brenda 60 ditëve nga miratimi i tyre.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8047, datë 11.9.2012, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Krenar Ymeraj, i datëlindjes 27.8.1950, lindur Tiranë dhe caktimin e shtetases Diana Ramizi si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 589, datë 5.7.2012, vendosi shpalljen të vdekur në datën 1 janar 1963 të shtetasit Dharmo Mekshi, i biri i Aleksit dhe i Kanos, i datëlindjes 18.2.1903, lindur në Zhej Gjirokastrë.

KËRKESË

Shtetësja Ilirjana Belegu, lindur dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Eduart Belegu.

KËRKUESJA
Ilirjana Belegu

KËRKESË

Shtetasi Arben Kamberi, i datëlindjes 15.6.1966, lindur dhe banues në Luz i Vogël, Kavajë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Flamur Kamberi, i datëlindjes 9.7.1971.

KËRKUESI
Arben Kamberi

Ndreqje gabimi

Në ligjin nr. 74, datë 19.7.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 17.8.2012 të bëhen këto ndreqje gabimesh:

- Në nenin 3, pika 3, në fund të germës ‘e’ në vend të pikës ‘.’ të vendoset pikëpresje ‘;’.
- Në nenin 5, pika 2, fjalët “Kuvendi Shqipërisë”, të bëhet “Kuvendi i Shqipërisë”;
- Në nenin 5, pika 3, germa a’, fjala “Komisioni” të bëhet “komisioni” si dhe po në këtë germë, fjala “antarëve” të bëhet “anëtarëve”. Në germën ‘b’ dhe ‘c’, fjalët “Nëse” dhe “Kur” të bëhen “nëse” dhe “kur”. Në pikën 3 të këtij neni, pas germave a’, b’, c’ dhe ç’, në fund të këtyre germave, në vend të pikës ‘.’, të vendoset pikëpresje ‘;’.
- Në nenin 13, pika 2 në rreshtin e gjashtë, fjalët “emërimi i kryetarit” të bëhet “emërimi i anëtarëve”. Po në këtë nen, në pikën 5, rreshti i parë, para fjalës “mungesave” të shtohet lidhëza “të”, si dhe në rreshtin e katërt të kësaj pike fjalët “librin e mbledhjeve”, të zëvendësohet me fjalët “Librin e Protokollit të Mbledhjeve”..
- Në nenin 20, pika 2, germa c’, fjalët “të këtij neni”, të bëhen “të kësaj pike”. Po në këtë nen, pika 4 fjalët “pikës 1”, të bëhet “pikës 2”.



- Në nenin 23, pika 1 fjalia e dytë, fjalët “Jo më vonë 15 ditë”, të bëhet “Jo më vonë se 15 ditë”. Po në nenin 23, pika 3, fillim rreshti i dytë, fjala “lista e zgjedhësve” të bëhet “ekstrakti i zgjedhësve”.
- Në nenin 24, pika 1, rreshti i dytë, fjalët ‘sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 51’ të bëhet ‘sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51’.
- Në nenin 25, pika 2, germa ç’, fjala “neni 62”, të bëhet “nenin 62”.
- Në nenin 28, në titullin e këtij neni lidhëza “të zgjedhësve”, të bëhet “së zgjedhësve”. Po në këtë nen, pika 2, rreshti i dytë, fjalët ‘në pikën 3 të nenit 46’ të bëhet ‘në pikën 2 të nenit 46’. Po në këtë nen, në fund të pikës 6 e tij, fjala “në pikën 1 të nenit 56” të zëvendësohet me fjalën “në pikën 1 të këtij neni”
- Në nenin 33, pika 4, fjala “përcaktura” të bëhet “përcaktuara”. Po në këtë nen në pikën 6, rreshti i tretë para fjalës “kryejnë” të shtohet lidhëza “të kryejnë”, si dhe në rreshtin e gjashtë fjala “përbushje”, të bëhet “përmbushje”. Në pikën 7 rreshti i dytë fjala “vërejte”, të bëhet “vërejtje”.
- Në nenin 34, **KREU III**’ të bëhet “**KREU IV**”. Po në këtë nen, në fund të pikës 1 të hiqet fjalia “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1 të nenit 59 të këtij Kodi”, si dhe te pika 6 para fjalës “qendrës”, të shtohet lidhëza ‘e qendrës’. Po në këtë nen, pika 5 e tij, fjala “pikën 1 të nenit 51” të zëvendësohet me fjalën “pikën 4 të nenit 51”.
- Në nenin 42, pika 2 fjala “të nëshkruar”, të bëhet “të nënshkruar”.
- Në nenin 43, pika 2, germa b’, pas fjalës “mbiemrin”, të vendoset presje ‘.’.
- Në nenin 46, germa c’, fjala “jashtëparlamentare” të zëvendësohet me fjalën ‘joparlamentare’.
- Në nenin 49, pika 4 fjala “identifikur” të bëhet “identifikuar”.
- Në nenin 51, në fund të germave a’, b’, dhe c’, në vend të pikës ‘.’, të vendoset pikëpresje ‘;’, si dhe fillimi i fjalive të të gjitha germave të fillojnë me shkronjë të vogël.
- Në nenin 52, mbas Pjesës VII dhe titullit të saj, të shtohet emërtimi, **KREU I**’, si dhe në pikën 5, ndërmjet fjalëve “Këshilli Ministrave” të shtohet lidhëza ‘i’.
- Në nenin 53, pika 6, fjala “përftuar” të bëhet “përfituar”.
- Në nenin 58, në fund të pikës 1, fjalia “nën vlerën e parashikuar në pikën 1 të nenit 90” të zëvendësohet me fjalinë “nën vlerën e parashikuar në pikën 2 të nenit 90”.
- Në nenin 59, pika 2, germa a’, ndërmjet fjalëve “mund caktohet” të shtohet lidhëza ‘të’.
- Në nenin 68, pika 4, para fjalëve “këtij Kodi” të shtohet lidhëza ‘të’.
- Në nenin 70, pika 5 fjalët ‘me nenin 324/a i Kodit Penal’ të bëhet ‘me nenin 248 të Kodit Penal’.
- Në nenin 71, pika 3, fjala ... “si dhe plotëson proceverbalin..” të bëhet .. “si dhe plotëson procesverbalin”.
- Në nenin 73, pika ‘ç’, në fjalinë e dytë, fjala “proceverbal” të bëhet “procesverbal”. Po në këtë nen, pika 6’, fjalia e tretë, mbas fjalës ...në Kutinë e Materialeve të Votimit, të shtohet ‘e’, dhe fjalia të bëhet ‘në Kutinë e Materialeve të Votimit, e cila më pas vulozet...’ si dhe këto fjalë të cilat janë me të mëdha të bëhen me shkronja të vogla.
- Në nenin 76, pika 3, fjalia e katërt, fjala ‘ ... dhe Procesverbali i Mbylljes ...’ të zëvendësohet me fjalën “....dhe Procesverbali për Mbylljen e’
- Në nenin 79, pika 3 në dy fjalitë ku përsëriten fjalët si, “procesverbalit të yulosjes” të zëvendësohet me fjalën “**Procesverbalit të Vulosjes**”.
- Në nenin 80, të rinumërtohen pikat, pasi mungon pika 3’ dhe renditja të jetë, 1...-10. Në fund të pikës 7 (pas rinumërtimit), në fund të fjalisë, fjala “sipas pikës 9 të këtij neni” të bëhet “sipas pikës 8 të këtij neni”. Në pikën 10 (pas rinumërtimit), fjala e cila përsëritet dy herë, “sipas pikës 9 të këtij neni” të bëhet “sipas pikës 8 të këtij neni”.

Po në këtë nen, në pikën 5, në fjalinë e dytë, fjalia "...një rubrikë për votat e për organet e tjera,..." , lidhëza e, të hiqet. Po në këtë nen, në pikën 6, fjala "**të palosuara**", të bëhet "**të palosura**".

- Në nenin 82, në pikën 4, fjala "**proceduarve**" të bëhet "**procedurave**".
- Në nenin 102, në pikën 1, në fjalinë ... "për Kuvendin dhe 50 000 lekë në rastin e e zgjedhjeve", të hiqet njëra 'e'.
- Në nenin 104, pika 2, fjalia '...nuk cenon zbatimin e pjesor të SEN-it dhe SEV-it'..., të hiqet shkronja e panevojshme 'e'.

Te seksioni i shtojcave

- Te shtojca **II**, te seksioni 4 - Personat përgjegjës për numërimin dhe mbikëqyrja e procesit, fjala në fund të pikës 2 "**barazpeshën**", të bëhet "**baraspeshën**". Po në këtë shtojcë, te seksioni 6 - Numërimi i fletëve të votimit, në pikën 2, fjala "**numërohen**", të bëhet "**numërohet**". Po në këtë seksion, në fund të pikës 2, fjala "**Proceverbalin**" të bëhet "**Procesverbalin**". Po në këtë seksion, në pikën 3, fjalia e dytë .. '**kutinë/kutitë të votimit**', të bëhet "**kutinë/kutitë e votimit**", si dhe fjalët "**procesverbalit të konstatimit**" të bëhet "**Procesverbalit të Konstatimit**". Në pikën 4 të këtij seksioni, fjalët, "**Kutinë me Materialet e Votimit**" të bëhen "**kutinë me materialet e votimit**", si dhe fjala '**seksionit 3**', të bëhet '**seksionit 4**'.
 - Në seksionin 6 - Numërimi i fletëve të votimit', pika 3, fjala "**..fletës e shpërndara..**" të bëhet "**fletët e dorëzuara**". Po në këtë seksion, pika 6, rreshti 2, fjalia "**në pjesën e pasme të fletës, nga ana e sipërme**" të bëhet "**me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme**".
 - Në seksionin 6 - në fund të pikës 8, fjala "**si dhe për mënyrën e trajtimit**", lidhëza '**për**' të hiqet.
 - Në seksionin 7 - Vlerësimi i votave dhe nxjerja e rezultatit nëpërmjet SEN-it, pika 9, fjalët "**librin e protokollit**" të bëhet "**Librin e Protokollit të Mbledhjeve**". Në pikën 10 të këtij seksioni, fjala "**vëshguesit**" të bëhet "**vëzhguesit**". Në pikën 11, fjalia e dytë, fjala "**Një kopje e tabelës i jepet vëzhguesve**" bëhet "**Një kopje e tabelës u jepet vëzhguesve**".
 - Në pikën 12 të këtij seksioni, kudo që përsëritetet fjala, "**procesverbalit të vulosjes**", të bëhet "**Procesverbalit të Vulosjes**".
 - Në shtojcën III, seksioni I, në fund të pikës 2, fjalia "**si dhe në çdo çështje**" të bëhet, '**si dhe çdo çështje**'. Në seksionin 4 fjalia "**Ky raport i jepet**" të bëhet "**Ky raport u jepet**". Në pikën 3 të këtij seksioni fjala, **pro**, të vendoset në thonjëza "**pro**".
 - Shtojca **III**, Seksioni II, pika 2, reshti 2, fjala "**dokumentit të identitetit**" të bëhet "**dokumenti i identifikimit**", e njëjta gjë vlen edhe për seksionin 5 të kësaj shtojce ku fjala "**.... e identitetit..**" të bëhet "**identifikimit**".
 - Në pikën 4 të seksionit 5, - **Procedurat në qendrën e votimit, shtojca III**, fjala "**sipas pikës 3 të seksionit 2 të kësaj shtojce**", të bëhet "**sipas pikës 3 të seksionit 3 të kësaj shtojce**".

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 5.11.2012
Doli nga shtypi më 6.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 37 lekë